

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-22-0548-A0001*****Në ankesën e******Paditësi*****E B**, fshati S e M, Fushë Kosovë.**Kundër*****E paditura/ankuesja*****NSH "Ramiz Sadiku" (në likuidim)**, të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-6276 të datës 29 gusht 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 07 mars 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditurës refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV-14-6276 të datës 29 gusht 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë ankimore.**

**Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me 26 shtator 2014, paditësi përmes postës e dërgoj një ankesë në DHPGJS të paraqitur kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRZ035-0698 të datës

27 gusht 2014, me të cilin vendim ishte refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhë të pa caktuar, në shumë prej 4,692.30 euro, me arsyetimin se kërkesa është parashtruar jashtë afatit për dorëzimin e kërkesave tek AL e që ishte dt. 13 gusht 2007.

Në ankesë paditësi e konteston vendimin e AL, duke pohuar se ai ka ushtruar kërkesë në AKM për kompensimin e pagave në shumë prej 4,692.30 euro pasi që më 27 qershor 2006 kishte marrë njoftimin se "pagat e pa paguar u mbesin borxh juve nga punëdhënësi dhe për realizimin e tyre ju do të kontaktoheni kur të fillojnë procedura e likuidimit" por një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Paraqitësi i kërkesës pasi që ju kishte ndërprerë marrëdhënia e punës ai ishte punësuar në ndërmarrjen private M dhe ajo e kishte transferuar në Kazakistan. Ankuesi arsyetohet për vonesën e tij lidhur me dorëzimin e kërkesës pranë AL-së duke e ndërlidhur me atë se nuk ka qenë në gjendje ta përcjell shtypin e Kosovës dhe se ka qenë e pamundur të kontaktoj me zyrtarët e AKM-së. Në mbështetje të ankesës, paditësi ka dorëzuar dokumentet në kopje si: vendimin e kundërshtuar, pasaportën dhe vizën e punës e periudhës 16 maj 2007-18 tetor 2007, regjistrin e pagave me nr.109, të datës 28 gusht 2006.

Me parashtresën e dt. 24 shkurt 2017 paditësi ka dorëzua në DHPGJS një listë të pagave për vitin 2006, prej 01 prill 2006 deri me 27 qershor 2006, të NSh-së në të cilën figuron edhe emri i tij.

Me 17 qershor 2020, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja pohon se ankesa e paditësit është pa vlefshme dhe e pa bazuar, ankesa dhe argumentet e parashtruesit janë të pa vlefshme dhe se arsyetimi ligjor i vendimit është i bazuar në fakte të verifikuara nga një lexim korrekt i Ligjit 04/L034. AKP-ja në mbrojtjen në ankesë ka konsideruar se shprehimisht e kundërshton ankesën si të pa pranueshme për shkak se paditësi nuk e ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm, në këtë rast nuk ka bashkangjitur justifikimin e besueshëm se pse kërkesa është dorëzuar me vonesë,

siç e parasheh i parasheh ligji 04/L034 në nenin 35.3, e as dokumentet mbështetëse ashtu siç është kërkuar në vendimin e datës 28 gusht 2014 të lëshuar nga AL-ja. Si përfundim AKP-ja rekomandon që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe e pa vlefshme.

Më 17 maj 2022, shkalla e I-rë lëshoi urdhër për paditësin me të cilin ka kërkuar nga i njëjti që të sjellë prova shtesë dhe të sqaroj lartësinë e pagës mujore.

Më 27 maj 2022, ankuesi duke u përgjigjur në urdhrin e gjykatës dorëzoi kopjen e letër njoftimit, kopjen e librezës së punës me numër 100860, kopjen e letër konfirmimit të datës 27 maj 2019, kopjen e listës së pagave 1/3 20058, 04/2005, 06/2005, 7 dhjetor 2005, kopjen e regjistrit-lista e pagave për vitin 2006 me nr.109, kopjen e kërkesës të dorëzuar pranë AKP-së me datën 27 gusht 2007, kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës NSH. dt. 27 qershor 2006, njoftimin për likuidimin e N.SH "Ramiz Sadiku", Prishtinë të shpallur në Gaztën KOHA Ditore dt. 12 qershor 2007.

Me 29 gusht 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-6276 e aprovon ankesën e paditësit si të bazuar, e ndryshon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN035-0698, datës 27 gusht 2014, dhe obligon të paditurën AKP-ja që ankuesit E B në emër të kompensimit për paga të pa paguara për periudhë të pa caktuar, t'ia paguajë shumën 4,692.30 euro. Shumat e aprovuar si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurë të likuidimit.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se nuk ishte kontestuese në mesë të palëve fakti se paditësi ishte punëtor i NSH-së. Por kontestuese në mesë të palëve ishte çështja se kërkesa e paditësit a ishte e afatshme para AL. E paditura e ka kundërshtuar kërkesën e paditësit duke pretenduar se i njëjti nuk e ka plotësuar padinë me dokumentacionin e nevojshëm në rastin konkret nuk e ka bashkangjitur justifikimin e besueshëm se pse kërkesa është dorëzuar me vonesë.

Paditësi në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur kopjen e vizës për punë në R. Të Kazakistanit e cila mban datën 16 maj 2007, periudhë e cila vërteton se i njëjti ka qenë jashtë vendit në kohën kur janë publikuar njoftimet në gazetën Koha Ditore, të datës 08 qershor 2007 dhe 12 qershor 2007. Paditësi kishte dorëzuar edhe provat shtesë me të cilat, shkalla e I-rë ka konstatuar se nga lista për pagat e pa paguara të punëtorëve është vërtetuar se paditësi kishte paga të pa paguara nga NSH-ja në shumë prej 4,692.30 euro. Shkalla e I-rë me rastin e aprovimit të kërkesës së paditësit është bazuar në listën e pagave të pa paguara dhe ka arritur në përfundim se paditësi ka ofruar shërbime pune për NSH për periudhën janar, shkurt, mars 2005 në shumën prej 1,014.00 euro, prill 2005 prej 85,80 euro, maj 2005 shumën prej 97,80 euro, qershor 2005 shumën prej 364,50 euro, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor 2005 total 2,172.40 euro, prill, maj, qershor 2006 total 957.80 euro, që do të thotë se NSH-ja i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 4,692.30 euro. Shkalla e I-rë në arsyetim të Aktgjykimit ka konstatuar se e paditura nuk e ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se paditësi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH-në në periudhën e lartë cekur, apo se nuk i ka mbetur borxh, ashtu siç përshkruhet në listën për pagat e pa paguara. Shkalla e I-rë ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë në këtë çështje. Shkalla e I-re ka konstatuar se pretendimi i të paditurës se kërkesa e paditësit është e pas aftashme dhe e pa pranueshme, nuk është i saktë.

Shkalla e I-rë krejt në përfundim ka konstatuar se paditësi, kishte ofruar shërbime pune për NSH dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh pagat e pa paguara në shumën e aprovuar.

Me 23 shtator 2023, AKP-ja e dërgon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-6276, të datës 29 gusht 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar duke e refuzuar ankesën kundër Autoritetit të Likuidimit si të pa bazuar dhe të vërtetohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit. AKP-ja në ankesën e parashtruar thekson se shkalla e I-rë e DHPGJS ka

ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra. Autoriteti Likuidimit nuk e ka mohuar faktin se ndërprerja e marrëdhënies së punës së parashtruesit i është ndërprerë për shkak të privatizimit gjithashtu autoriteti I likuidimit ka sqaruar shumë qartë se janë dy afate të ndryshme të parashkrimit të cilat Autoriteti i likuidimit është i obliguar t'i pranojë dhe përmes të cilave Autoriteti i Likuidimit e aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë është afati për dorëzimin e kërkesave para AL dhe fati dytë ka të bëjë me meritat e të drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar ta zbatoj.

E paditura konsideron se neni 36.2, nën paragrafi 1 i Shtojcës së Ligjit 04/L034, mbi të cilën është bazuar vendimi i Autoriteti të Likuidimit, parashikon se: "... elementet në vijim përbejnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme për refuzim të kërkesës apo interesit të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: Kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme. Po ashtu e paditura rithekson se parashtruesi nuk e saktëson se cili nen i Ligjit 04/L034 është shkelur nga ana e Autoritetit të Likuidimit, duke shkelur Nenin 70.2 i shtojcës së Ligjit 04/L033 i cili parashikon se Ankesa" duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin 04/L034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Kështu duke marrë parasysh mos respektimin e Nenit 70.2 të Ligjit 04/L-033, padia e paditësit duhet të refuzohet si e pa bazuar.

Me 19 dhjetor 2023, paditësi e dorëzon në DHPGJS një parashtrësë dhe i përgjigjet ankesës së AKP-së. Në këtë parashtrësë paditësi e kundërshton ankesën e AKP-së si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Paditësi ka pohuar se aktgjykimin e ankimuar është vërtetuar se ai ishte punëtor i NSH-së, andaj aktgjykimi i atakuar duhet të vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e AKP-së është pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjorë, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 28 gusht 2007 e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me të cilën ai ka kërkuar të paguhen pagat e pa paguara nga NSH NIN "Ramiz Sadiku" (në likuidim), në shumë prej 4,692.30 euro. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se ajo ishte parashtruar jashtë afatit për dorëzimin e kërkesave e që ishte data 13 gusht 2007.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin e ankimuar e ka aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar dhe e ka obliguar AKP-në të i'a paguaj paditësit pagat e pa paguara në shume prej 4,692.30 euro, duke konstatuar se paditësi me kopjen e dozuar të vizës për punë në R. të Kazakistanit e cila mban datën 16 maj 2007, periudhë e cila vërteton se i njëjti ka qenë jashtë vendit në kohën kur janë publikuar njoftimet për dorëzimin e kërkesave tek AL përmes gazetë Koha Ditore, të datës 08 qershor 2007 dhe 12 qershor 2007. Shkalla e I-rë e po ashtu ka konstatuar se paditësi kishte dorëzuar edhe provat shtesë siç ishte lista e për pagat e pa paguara të punëtorëve me të cilat është vërtetuar se paditësi kishte paga të pa paguara nga NSH-ja në shumë prej 4,692.30 euro. Pra Shkalla e I-rë kishte arrit në përfundim se paditësi ka ofruar shërbime pune për NSH për periudhën janar, shkurt, mars 2005 në shumën prej 1,014.00 euro, prill 2005 prej 85,80 euro, maj 2005 shumën prej 97,80 euro, qershor 2005 shumën prej 364,50 euro, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor 2005 total 2,172.40 euro, prill ,maj, qershor 2006 total 957.80 euro, që do të thotë se NSH-ja i kishte mbetur borxh pagat në shumë prej 4,692.30 euro.

Kolegji i Apelit i mbështet në tersi konstatimet dhe të gjeturat faktike e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si të drejta dhe të mbështetura në dispozita ligjore.

Kolegji i Apelit nuk e mbështet konstatimin e AL dhe të AKP-së në procedurë të ankesës se kërkesa paditësit ishte paaftshem dhe e pabazuara.

Neni 35.3 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit përcakton se, nëse një kreditor i supozuar apo bartës i interesit paraqet arsyetim bindës për parashtrim të vonuar, Autoriteti i Likuidimit, në diskrecion vetanak, mund të pranojë dëshminë e kërkesës apo interesit të dorëzuar pas afatit për parashtrimin e kërkesave, nëse dëshmia e kërkesës apo interesit është parashtruar jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas afatit për parashtrimin e kërkesave. Tek paditësi ishte i mundur zbatimi i kësaj dispozite meqë ai kishte parashtruar kërkesë 15 ditë me vonesë dhe se në procedurë të ankesës tek Shkalla e I-rë, kishte ofruara dëshmi të mjaftueshme për paraqitjen e ankesës me vonesë siç ishte viza për punë në R. të Kazakistanit e cila mban datën 16 maj 2007, periudhë e cila vërteton se i njëjti ka qenë jashtë vendit në kohën kur janë publikuar njoftimet për dorëzimin e kërkesave tek AL përmes gazetë Koha Ditore, dt. 12 qershor 2007.

Kolegji i Apelit konsideron se Shkalla e I-rë ka vendosur drejtë kur ka konstatuar se e paditura nuk e ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH-në në periudhën e lartë cekur, apo se nuk i ka mbetur borxh, ashtu siç përshkruhet në listën për pagat.

Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja nuk e ka kontestuar shprehimisht lartësinë e kërkuar të kompensimit në emër të pagave të pa paguara, andaj duke u bazuar në këtë fakt dhe në listën e pagave të cilën paditësi e ka sjellë si provë, Shkalla e I-rë e DHPGJS me të drejtë e ka aprovuar shumën e kërkuar prej 4,692.30 euro, në emër të pagave të pa paguara për periudhën e cekur, e cila shumë do të paguhet nga ana e AKP-së sipas prioritete të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Andaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

AKP-ja me datë 11 tetor 2022, e ka paguar taksën gjyqësore në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 07 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

---